



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

**Nr. 91- Janar- 2011 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>
dhe www.malisheva-komuna.org**





Përmbajtja:

Deklaratë për ngjarjen e 1 janarit 2011, që ndodhi në Banjë të Malishevës..	2
Asambleja Komunale e Malishevës, dënon rastin tragjik të 1 janarit 2011...	2
Kryetari Kilaj do të takohet me qytetarët edhe gjatë këtij viti	3
Formohet komisioni komunal i regjistrimit, për komunën e Malishevës.....	4
Më shumë projekte dhe shërbime më të mira publike	5
Kryetari Kilaj, priti në takim lamtumirës komandantin e BSHJ-së, Stephan Thomas	6
KPF-ja dha dy rekomandime për KK	7
Prezantohet projekti “Vlerësimi i Kapacitetit Komunal-Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive-DEMI”	8
Mbi 56 % më shumë të hyra nga tatimi në pronë në vitin 2010	9
2011-ta me shërbime publike më të mira dhe zbatim të rregulloreve	10
Kryetari Kilaj, derën hapur për qytetar	12
Komuna dhe OSBE do të mbajnë takime të rregullta çdo dy javë	10
Kërkohet më shumë aktivitet i inspektorëve komunal	13
Asambleja Komunale mbajti mbledhjen e njëmbëdhjetë të radhës	14
Të kursehet lënda djegëse në institucione	15



Deklaratë për ngjarjen e 1 janarit 2011, që ndodhi në Banjë të Malishevës

Malishevë, 2 janar

Sulmi, vrasjet mizore, torturimi i familjes Limaj, shokoi të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës. Sulmi ishte sjellje dhe veprim mesjetar.

Vrasja e babait, në prani të fëmijëve të tij, është vepër krimi e terrori.

Ne, të gjithë, qytetarët e komunës së Malishevës, që njihet vend i qetë dhe dashamirës, distancohemi nga këto veprime të shëmtuara.

Ngjarjes së 1 janarit, i parapriu, politika nxitëse e deklaratave të Albin Kurtit dhe Gllauk Konjufcës, të cilat duhet të jenë argumente të fuqishme për për drejtësinë, që duhet të marrin veprime të duhura ligjore.

Unë bëj thirrje për maturi të të gjithëve në këto raste.

Kosova ka organet e saja ligjore, të dala nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, për të cilën dhamë aq shumë, prandaj respektojeni.

Lutem që kjo ngjarje të jetë e fundit për Malishevën dhe Kosovën në përgjithësi.

Asambleja Komunale e Malishevës, dënon rastin tragjik të 1 janarit 2011

Malishevë, 10 janar

Asambleja Komunale e Malishevës, në një mbledhje urgjente të mbajtur sot, ka dënuar rastin tragjik, të ndodhur në familjen Limaj, më datë 01.01.2011, në fshatin Banjë, me ç'rast u vra Skender Limaj dhe u plagosen dy anëtarë të tjerë.



Në vazhdim teksti i deklaratës:

Deklaratë e Kuvendit të Komunës së Malishevës

Përmes të së cilës, KK i Malishevës, dënon rastin tragjik të ndodhur në familjen Limaj, më datë 01.01.2011, në fshatin Banjë, me ç'rast u vra Skender Limaj si dhe u plagosen dy anëtarë të të njëjtës familje.

Kjo ngjarje ishte tronditëse për familjen Limaj, por edhe për ne anëtarët e Kuvendit, qytetarët e Komunës së Malishevës si dhe për tërë popullin shqiptar.

Rasti ka dëmtuar rëndë imigjin e Komunës së Malishevës, si një ndër komunat më të qeta në Republikën e Kosovës.

Ne anëtarët e Kuvendit të komunës së Malishevës, i shprehim ngushëllime familjes Limaj, njëherit kërkojmë nga organet e drejtësisë që akterët e këtij krimi të rëndë për Malishevën t'i vërë para drejtësisë.

Kryetari Kilaj do të takohet me qytetarët edhe gjatë këtij viti

Malishevë, 13 janar

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, edhe në vitin 2011, do të vazhdoj me pritjen e palëve në zyrën e tij, çdo të enjte, në mënyrë që të njihet drejtpërdrejt me



brengat dhe nevojat e qytetarëve të Komunës që ai udhëheqë, si dhe t'ju ofroj mbështetjen për zgjidhjen e problemeve, brenda mundësive dhe kompetencave të këtij institucionit.

Gjatë ditës së sotme ka pritur një numër të konsiderueshëm të qytetarëve, duke ju ofruar mbështetje dhe këshilla të nevojshme, për problemet e caktuara, me të cilat përballen ata.

Si në çdo rast, dominojnë çështjet socio – ekonomike, duke përfshirë këtu, kërkesat për ndihma të ndryshme, pastaj çështjet shëndetësore, si dhe kërkesa të nxënësve dhe student, për t'i mbështetur në shkollimin e tyre.

Formohet komisioni komunal i regjistrimit, për komunën e Malishevës

Malishevë, 13 janar

Me vendim të Kryetarit të Komunës, z.Isni Kilaj, bazuar në ligjet në fuqi dhe Statutin e Komunës së Malishevës, është formuar komisioni komunal për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe banesave.

Komisioni Komunal për këtë regjistrim, përbëhet prej tetë anëtarëve, të cilët edhe parashihen me ligj dhe ky komision do të punojë nën autoritetin e kryetarit të komunës, konform rregullave të parapara ligjore sipas Ligjit nr.03/L-237, për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe banesave.



Komisionin për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe banesave, sipas ligjit e udhëheq Kryetari i Komunës, Isni Kilaj, ndërsa anëtarët tjerë të komisionit janë: Haki Krasniqi- anëtar, Muharrem Morina-anëtar, Hatixhe Bashota-anëtare, Sali Bytyçi-anëtar, Besim Dobruna-anëtar, Afrim Selimi-anëtar dhe Feride Hoxha-anëtare, nga pjesa e shoqërisë civile.

Më shumë projekte dhe shërbime më të mira publike

Malishevë, 17 janar

Në mbledhjen e parë për vitin 2011, Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, fillimisht uroi për detyrën, drejtorin e ri për Inspektorat, z.Ismet Kafexholli, nga i cili kërkoi angazhim në punë dhe shërbime më efikase nga ana e inspektorëve, ndërsa për të gjitha drejtoritë kërkoi hartimin e projekteve ideore për vitin 2011, si dhe për angazhim për shërbime publike më të mira.

“Të kemi projekte ideore gjatë këtij viti, projekt ide të qarta, reale dhe brenda buxhetit, por edhe të tjera që mund të realizohen përmes donacioneve të ndryshme, përfshirë këtu edhe ato që mund të realizohen nga Banka Botërore”, tha kryetari Kilaj.

“Shërbimet Publike, duhet të jenë më efikase dhe kompanitë që kryejnë këto shërbime duhet të jenë më aktive dhe ti zgjerojnë shërbimet e tyre në tërë territorin e komunës”, u shpreh më tej z.Kilaj, i cili gjithashtu kërkoi edhe bërjen e një shpimi të thellë në fshatin Bubël, në kërkim të ujit të pijes, në mënyrë që të zgjerohet ndërtimi i sistemeve të ujësjellësve për fshatra tjera.

Në këtë takim është kërkuar edhe hartimi e projekteve për fushën futbollit të madh, pastaj ndërtimi i objektit të emergjencës, pranë QKMF-së, pastaj menaxhimi i mbeturinave dhe pyjeve, si dhe zbatimin e rregulloreve që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e ambientit, në veçanti rrugëve, në mënyrë që të mos dëmtohen rrugët dhe të parandalohet depërtimi i baltës, përmes makinave dhe punimeve që bëhen në afërsi të rrugëve.

Një çështje tjetër me rëndësi që është kërkuar nga drejtoritë, është edhe disiplina në punë dhe rritja e cilësisë së shërbimeve, në mënyrë që të jenë sa më efikase.

Kryetari Kilaj, priti në takim lamtumirës komandantin e BSHJ Stephan Thomas

Malishevë, 17 janar



Kryetari i Komunës së Malishevës z. Isni Kilaj, priti në takim lamtumirës, komandantin e Brigadës Shumëkombëshe të Jugut, gjeneralbrigade Stephan Thomas.

Gjatë këtij takimi janë shkëmbyer falënderime për bashkëpunimin reciprok të treguar gjatë shtatë muajve sa ka qenë në detyrë gjenerali Thomas.



“Z. Gjeneral, ju faleminderit për kontributin e dhënë gjatë këtyre 7 muajve, në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë, por edhe për lirinë e saj në përgjithësi”, është shprehur kryetari i komunës në adresë të komandantit të BSHJ, duke përmendur më pas disa nga projektet e realizuara së bashku në të kaluarën, dhe duke shpresuar që në të ardhmen do të ketë realizime të tjera të projekteve në interes të qytetarëve. Ndërsa si uratë për gjeneralin, kryetari Kilaj shtoj se “shpresoj që këta shtatë muaj sa keni kontribuar në Kosovë, t’i keni kaluar aq mirë që t’ju jet krijuar përshtypje për tu rikthyer përsëri këtu”.

Në anën tjetër gjenerali Thomas, ka vlerësuar dhe falënderuar siç u shpreh ai “ për derën e hapur që ka treguar komuna e Malishevës, me qëllim të diskutimit dhe trajtimit të çështjeve të ndryshme”, ndërkohë që vlerësoj lartë çështjen e sigurisë në Malishevë dhe vlerësoj lartë punën e policisë dhe ndryshimet pozitive që janë bërë në Kosovë.

Në fund të takimit janë shkëmbyer dhurata modeste, si dhe është ftuar kryetari, që të enjten, të marrë pjesë në ceremoninë përshëndetëse që do të organizohet nga BSHJ në Prizren, me rastin e përfundimit të mandatit të gjeneralbrigade Stephan Thomas.

KPF-ja dha dy rekomandime për KK

Malishevë, 18 janar

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), në mbledhjen e shtatë të radhës të udhëhequr nga kryesuesi Ragip Begaj, rekomandoi për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit Komunal; njëra e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Grupit të Veprimit Rinor Lokal (GVRL).



KPF, shqyrtoi dhe rekomandoj për asamble kërkesën e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, për planin Vlerësimi të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për Komunën e Malishevës, ndërsa sqarimet e nevojshme, për anëtarët e KPF-së, i dha drejtori Halit Zogaj.

Po ashtu, në këtë mbledhje u shqyrtua, propozimi i Grupit të Veprimit Rinor Lokal, që të diskutohet dhe miratohet plani i veprimit rinor lokal për Komunën e Malishevës.

Në fund të takimit, anëtarët e KPF-së, janë njoftuar me kërkesat e drejtuara në këtë organ, por për asnjë prej tyre nuk u mor asnjë vendim.

Nga përfaqësues të USAID-i amerikan

Prezantohet projekti “Vlerësimi i Kapacitetit Komunal- Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive-DEMI”

Malishevë, 18 janar

Sot në komunën e Malishevës, ka qëndruar një ekip i USAID-it amerikan, të cilët kanë prezantuar projektin, “ Vlerësimi i Kapacitetit Komunal- Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive- DEMI” .



Dokumenti ka të bëjë me vlerësimin, si mjet matës për të kuptuar kapacitetet dhe sfidat e komunës.

Këtij dokumenti, i janë përgjigjur të gjithë drejtorët e qeverisë komunale, kryesuesi i kuvendit dhe kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj.

“Ky pyetësor për vetë vlerësim është zhvilluar për të mbështetur ndërtimin e një kulture të përsosmërisë. Ka shumë organizata që kanë ndërmarrë vetë vlerësimin dhe kanë konfirmuar që është i nevojshëm në mënyrë që të implementohen qëllimet strategjike. Vetë vlerësimi është një proces që udhëheq ekipet tuaja menagjuese në rritjen e njohurive në disponueshmërinë e burimeve dhe në mënyrën se si ato mund të ndahen/alokohen. Rezultatet e pyetësorit do të shqyrtohen nga stafi i DEMI-t dhe do të prezantohen në çdo komunë ku pastaj bashkërisht do të përpilojmë planin e veprimit komunal të DEMI”, kështu thuhet në mes tjerash në dokumentin që ka të bëjë me vlerësimin e kapacitetit komunal.

Realizimi i këtij procesi në ditën e sotme është bërë nga z. Halit Kadriu, z. Nijazi Kuci, znj. Valbona Tahiri, si pjesë përbërëse e DEMI-t, së bashku me drejtorët e drejtorive komunale dhe kryetarin Isni Kilaj.

Vlen të përmendet se në këtë pyetësor janë të përfshira gjashtë seksione: udhëheqja dhe menagjmenti, administrata komunale, kuvendi komunal, ofrimi i shërbimeve, pjesëmarrja e qytetërave dhe zhvillimi ekonomik lokal.



Mbi 56 % më shumë të hyra nga tatimi në pronë në vitin 2010

Malishevë, 19 janar

Të hyrat nga tatimi në pronë, gjatë vitit 2010, janë realizuar 56.56 përqind më shumë se shuma e planifikuar, kurse në raport me vitin paraprak, është realizuar 50.21 përqind më shumë.

“Planifikimi për vitin 2010, për realizimin e të hyrave nga tatimi në pronë, ka qenë 120 mijë euro, ndërsa janë realizuar 187.881 euro, apo shprehur në përqindje, 56.56 përqind më shumë se planifikimi”, tha Avni Krasniqi, shef i zyrës së tatimit në pronë në Komunën e Malishevës.

“Po ashtu edhe në raport me vitin paraprak, është shënuar rritje për 50.21 përqind më shumë”, bëri të ditur Krasniqi, pasi sipas raporteve nga kjo zyrë, në vitin 2009, ishin realizuar 125 mijë euro, ndërsa këtë vit janë realizuar rreth 62 mijë euro më shumë.

Zyra e tatimit në pronë, çdo vit tejkalon planifikimet për realizimin e të hyrave dhe gati çdo vit, Komuna e Malishevës, ka qenë përfituese e granteve qeveritare, si rezultat i realizimit të të hyrave nga ky sektor.

2011-ta me shërbime publike më të mira dhe zbatim të rregulloreve

Malishevë, 19 janar

Drejtoritë për Shërbime Publike, Inspektorati, Urbanizmi, ajo për Mbrojtje dhe Shpëtim, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, ndërmarrjen për menaxhimin e mbeturinave “Eko-regjioni” dhe atë të ujërave “Hidroregjioni”, me kërkesën e Qeverisë Komunale, duke filluar nga dita e nesërme (e enjte), do të fillojnë zbatimin rigoroz të rregulloreve për pastërtinë, shërbime publike dhe rregullimin e komunikacionit.



Këto shërbime, kanë dalë me rekomandime, pas një takimi të përbashkët, ku është kërkuar zbatimi i ligjit dhe rregulloreve, nga të gjitha subjektet afariste, si ndotësit më të mëdhenj të ambientit, si dhe nga qytetarët dhe vozitësit në komunikacion, në mënyrë që të ruhet ambienti i pastër, të shmangen tollovitë në komunikacion nga parkimi pa vend i veturave, por edhe nga keqpërdorimi i ujit nga lokalet afariste, të cilat edhe po krijojnë baltë në rrugët e qytetit.

Rekomandimet e dala nga ky takim janë : 1)Ndalimi i parkingjeve për tregtimin e makinave, jashtë tregut, në rrugë me baltë dhe mbi trotuare, 2)Ndalimi i parkingjeve në



vendet ku nuk është tabela treguese për parking, 3) Ndalimi i gjurmëve të dheut që po bëhet në kohë me shi, lagështi apo në ditë tregu, 4) Ndalimi i derdhjes së ujit të pakontrolluar nga bizneset nga trotuari në rrugë dhe mos hedhja e mbeturinave në vende të përshtatshme, 5) Vendosja e kontejnerëve në vende të përshtatshme dhe që nuk pengojnë, 6) Ndalimi i shfrytëzimit të hidrantit afër stacionit policor, 7) Pastrimi i të gjitha pusëve të ujërave atmosferik.

Policia e Kosovës, ka garantuar siguri për shërbimet, të cilat do të merren zbatimin e këtyre rekomandimeve, ndërsa është kërkuar aktivitet i shtuar i inspektorëve komunal, pajisja e subjekteve afariste me rregulloret komunale, menaxhim më i mirë i mbeturinave dhe ujërave, si dhe u kërkuar që të zbatohen gjobat për shkelësit e rregullave, kurse gjykatat të jenë më efektive me lëndët që dërgohen nga këto shërbime, për shkelësit e rregulloreve.

Ndërsa, nga e dita e premte, njësia për menaxhimin e ujërave, “Hidroregjioni”, ka bërë të ditur, se do të fillojë pastrimin e pusëve të bllokuara nga ujërat atmosferik, si pasojë e baltës dhe rërës, kurse policia, paralajmëron se do të gjobis punëkryesit, që gjatë gjurmëve të dheut, e bartim baltën në rrugë, përmes gomave të kamionëve.

Kryetari Kilaj, derën hapur për qytetar

Malishevë, 20 janar

Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, si çdo të enjte, edhe sot ka pritur qytetarët, për tu njohur me problemet e tyre, të cilat mund të zgjidhen nga institucioni i komunës, duke iu ofruar mbështetje.



Këtë të enjte, numri i qytetarëve ishte më i vogël se ditëve tjera, ndërsa kërkesat e tyre kryesisht ishin të natyrës sociale, banimit, por kishte edhe prej atyre që kanë të bëjnë me zgjidhjen e problemeve infrastrukturore (kanalizime).

Në të gjitha rastet, kryetari Kilaj, iu është përgjigjur për mënyrën e realizimit të nevojave të tyre, ndërsa në rastet ku komuna mund të ofroj zgjidhje, kryetari iu ka premtuar zgjidhje.

Komuna dhe OSBE do të mbajnë takime të rregullta çdo dy javë

Malishevë, 20 janar

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj dhe Ümit Aynaci, zyrtar i ekipit komunal të OSBE-së për Malishevë, gjatë një takimi të mbajtur sot, janë dakorduar që takimet zyrtare mes dy palëve, të jenë dy javore, në mënyrë që të rritet bashkëpunimi i ndërsjellë mes Komunës së Malishevës dhe OSBE-së.

Në takimin e sotëm, është diskutuar edhe për bashkëpunimin në projekte të përbashkëta, në fusha të caktuara, në fokus të veçantë, rininë dhe organizatat joqeveritare (OJQ), në kuadër të një programi të OSBE-së, për financimin e projekteve të vogla, në fusha të caktuara, me të cilat merret kjo organizatë.



“Shumë nga projektet tona që i kemi realizuar, apo do të realizohen lidhen me rininë, OJQ-të dhe organizimet tjera të shoqërisë, siç është Qendra e Biznesit, Shtëpia e Kulturës, Pallati i Sporteve, ndërsa bashkëpunimi i komunës dhe OSBE-së, në këtë drejtim, është shumë i qëlluar”, tha kryetari Kilaj, duke ofruar bashkëpunimin e komunës, në këtë drejtim.

Zyrtarët e OSBE-së, e ftuan kryetarin Kilaj, në një takim, në Prishtinë, i cili organizohet nga OSBE-ja, në çdo fillim të vitit, ku marrin pjesë zyrtarë të lartë të vendit, përfshirë këtu edhe kryetarët e komunave.

Kërkohet më shumë aktivitet i inspektorëve komunal

Malishevë, 24 janar

Në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve, kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, kërkoi që shërbimi i Inspektoratit, të shtoj edhe më shumë aktivitete e saja në teren, në mënyrë që të respektohet të gjitha rregulloret, ndërsa drejtori i kësaj drejtorie, Ismet Kafexholli, ka njoftuar për aktivitetet e drejtorisë, gjatë javës së kaluar dhe për aktivitetet që do ti kenë gjatë kësaj jave.

“Gjatë javës së kaluar, inspektorët, ju kanë shpërndarë rregulloren dhe një informator për ligjin mbi duhanin, të gjitha subjekteve afariste, hoteliere dhe institucioneve, të cilët janë njoftuar me kushtet që duhet ti plotësojnë në raport me ligjin për përdorimin e duhanit në vende publike”, tha drejtori Kafexholli.

“Ndërsa gjatë kësaj jave, shërbimi i inspektoratit, do t’ju shpërndajë bizneseve dhe lokaleve afariste, rregulloren për mirëmbajtjen e pastërtisë, para lokaleve afariste”, tha Kafexholli, përderisa njoftoi se inspektorët komunal, “me kërkesën e Ministrisë për Tregti dhe Industri, kanë bërë verifikimi i thasëve të miellit, pas dyshimeve për sasi më të vogël në thasë të miellit, por që kanë rezultuar në rregull të gjitha rastet e verifikimit”.

Në fund të mbledhjes, kryetari Kilaj, kërkoi nga të gjitha drejtoritë, që ta shfrytëzojnë kohën dhe të hartojnë projekte, për fushat e veprimtarisë së drejtorive.

Asambleja Komunale mbajti mbledhjen e njëmbëdhjetë të radhës

Malishevë, 26 janar



Asambleja Komunale e Malishevës, e udhëhequr nga kryesuesi, z.Ragip Begaj, mbajti sot, mbledhjen e njëmbëdhjetë të radhës, ku janë shqyrtuar dy propozime, një nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Propozimi i parë është miratuar, propozimi i dytë është dërguar për shqyrtim në Komitetin për Arsimit dhe Kulturë.



Propozimi i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, për “Vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për komunën e Malishevës”, është miratuar unanimisht nga këshilltarët komunal në KK të Malishevës, me disa vërejtje-sugjerime, që në rishikimin pas gjashtë muajve, të merren parasysh edhe ato.

Fillimisht rreth këtij vlerësimi, e më pas edhe në pyetjet e këshilltarëve, ka sqaruar drejtori i kësaj Drejtorie, z. Halit Zogaj.

Kurse propozimi Grupit të Veprimit Rinor Lokal (GVRL), i cili është bërë përmes, Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për planin e veprimit rinor lokal, nga ana e këshilltarëve të KK-së, është dërguar për tu modifikuar dhe analizuar në Komitetin për Arsim dhe Kulturë, e më pas të kthehet për shqyrtim në Asamble, pasi, plani aktual, sipas këshilltarëve komunal, ka implikime buxhetore dhe rekomandimet e planit, nuk pasqyrojnë gjendjen reale të rinisë në Malishevë.

Në pikën e fundit, në shqyrtimin e kërkesave, ka pasur disa propozime nga ana e këshilltarëve komunal, në mesin e tyre edhe një propozim për formimin e një komisioni për inicimin e padisë ndaj shtetit serb për krimet e kryera në territorin e Komunës së Malishevës, propozim i cili do të shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale.

Vlen të përmendet se, në fillim të mbledhjes, këshilltari Januz Kastrati(LDK), e ka uruar për rezultatin e arritur, në zgjedhjet e fundit nacionale, këshilltaren Hasime Mazreku-Krasniqi (PDK), dhe i ka dëshiruar suksese, në mandatin e saj si deputete e Kuvendit të Kosovës, ndërsa në Hasime Mazreku-Krasniqi, pas këtij urimi, falënderoi Kastratin dhe votuesit e Malishevës, për besimin e dhënë dhe premtoi angazhimin e saj për Malishevën, pa marrë parasysh bindjet dhe orientimet partiake.



Të kursehet lënda djegëse në institucione

Malishevë, 31 janar

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve ka kërkuar nga drejtoritë përkatëse, që në përfundim të sezonit dimëror, të regjistrohet dhe evidentohet lënda djegëse nëpër institucionet, shkollore dhe institucionet tjera, në mënyrë që të kursehet lënda djegëse dhe të kemi pasqyrë të saktë të nevojës për ngrohje për sezonin e ardhshëm dimëror.

Në këtë mbledhje, gjithashtu, është paraqitur nevoja e vendosjes së shportave për mbeturina dhe cigare, nëpër qytet, në mënyrë që të mund të realizohet më lehtë zbatimi i rregulloreve për pastërti dhe përdorim të duhanit në vende publike.

Këshilli i Drejtorëve, ka vendosur që të ndihmoj me rreth dy mijë euro, pronarin e serrës së fidanëve, Jemin Sertollin nga Bellanica, pasi gjatë javës së kaluar, ka pësuar dëme të mëdha nga djegia e serrës.

Në këtë mbledhje, është diskutuar edhe çështja e regjistrimit të linjave urbane, pasi kompanitë e transportit, shumica prej tyre, nuk i kanë plotësuar kriteret e parapara për regjistrimin e linjave, përfshi kontrollimin teknik të mjeteve të transportit dhe detyrimet ndaj komunës, ndërsa është kërkuar që të mos lëshohet pe në asnjë rast, pasi kompanitë duhet ti plotësojnë të gjitha kriteret për transport të udhëtarëve.

Përgatitur nga Zyra për Informim Publik- Malishevë